



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më datë 15.10.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 04.10.2018.
2. Miratimi i kalendarit dhe programit të punës së komisionit.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia. Luan Duzha, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Klodjana Spahiu, Anduel Xhindi, Antoneta Dhima dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Myslym Murrizi, Paulin Sterkaj Ervin Salianji, Elona Hoxha Luan Harusha Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunksi dhe Isuf Çelaj.

Të ftuar:

Gazmend Barbullushi - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Jashtme

Daniela Çekani – Drejtoreshë e Fondeve IPA II

Rovena Voda- Zëvendësministre e Brendshme

Elona Hoxhaj- Drejtoreshë Juridike në Ministrinë se Brendshme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita! Hapim mbledhjen e Komisionit të Sigurisë Kombëtare.

Rendi i ditës i mbledhjes së sotme është:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 04.10.2018
2. Miratimi i kalendarit dhe programit të punës së komisionit.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”

Të nderuar kolegë, a jeni dakord me procesverbalin e mbledhjes së datës 04.10.2018?

Dakord.

A jeni dakord me kalendarin e programit të punës së këtij komisioni me të cilin jeni njohur ditën që kishim seancën plenare të kaluar?

Dakord.

Vazhdojmë me shqyrtimin e projektligjit të planifikuar për sot. Të ftuar kemi sekretarin Përgjithshëm të Ministrisë së Jashtme, zotin Gazmend Barbullushi, drejtoreshën e fondeve IPA, zonjën Danjela Çekani. Në fakt, ne kishim thirrur edhe përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, por mbetet për t’u parë pse nuk kanë ardhur.

Kjo është një marrëveshje, që është planifikuar të shqyrtohet në disa komisione njëherazi.

Fjala për ju, zoti Barbullushi. Do të donim të na prezantonit këtë marrëveshje, e cila, në fakt, është financiare, por përfshin pikat e kalimit kufitar, të cilat janë pjesë integrale përderisa bëhet fjalë për bashkëpunim ndërkufitar.

Gazmend Barbullushi - E nderuar zonja kryetare e komisionit,

Të nderuar deputetë, sot bashkë me kolegen Çekani kemi nderin të prezantojmë këtë projektligj.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje financiare krijon kushtet e nevojshme për zbatimin e përbashkët të projekteve për të ardhmen e Shqipërisë dhe Kosovës duke mundësuar në këtë mënyrë për përfituesit nga të dyja vende shkëmbimin e njohurive dhe përvojave, por edhe rezultatet e dukshme në sektorin e mjedisit , të turizmit e të tjera.

Projektligji për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje është propozuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 536 të vitit 2018, është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 449 të vitit 2017, është nënshkruar nga pala jonë në korrik të vitit 2017 dhe finalizuar nga pala kosovare në nëntor të vitit 2017. Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri- Kosovë 2014- 2020 është miratuar nga Komisioni Europian me vendimin e datës 11.12.2014.

Alokimet gjatë vitit 2016 në këtë program financohen nga një grant i Bashkimit Europian nëpërmjet instrumentit të asistencës së para anëtarësimit IPA, një buxhet total për të dyja vendet 1 milion e 411 mijë e 765 euro. Nga këto, bashkëfinancim kombëtar nga shtetet janë në nivelin e 180 mijë eurove, ndërsa kontributi i Bashkimit Europian është 1 milion e 200 mijë euro. Zona e programit që parashikon marrëveshja dhe ku do të zbatohen projektet mbulon një territor prej më tepër se 8 mijë kilometra katrorë me një popullatë që përfshin 936 mijë banorë, nga të cilët 76% janë në hapësirën e territorit të Kosovës dhe 24% në Republikën e Shqipërisë. Në Shqipëri zonat përfituese përfshijnë rajonet ose qarqet e Kukësit ose Lezhës, 8 bashki me një total prej 362 vendbanimesh ndërsa në Kosovë përfshin rajonin ekonomik perëndimor dhe rajonin ekonomik jugor me 12 bashki. Programi i bashkëpunimit Shqipëri Kosovë mbështet shkëmbimin e eksperiencës, njohurive dhe përmirësimin e politikave publike mes autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale, si edhe aktorëve të tjerë të rajoneve të lejueshme në zonën e programit, i cili ka për qëllim të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të zonave, si edhe të forcojë bashkëpunimin e natyrshëm mes dy shteteve.

Duke marrë parasysh problematikën në terren, programi do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme: së pari, mbrojtjen e mjedisit; përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike; parandalimin dhe menaxhimin e riskut. Së dyti, në turizëm dhe trashëgimi natyrore dhe kulturore, dhe, së treti, në çështjet e rinisë, arsimit me fokus nxitjet e punësimit.

Ermonela Felaj- Faleminderit!

Nëse zonja Çekani nuk ka ndonjë gjë për të shtuar për momentin, fjalën e ka relatori, zoti Pjerin Ndreu.

Pjerin Ndreu - Faleminderit!

Unë nuk dua të shtoj më shumë nga sa u tha, sepse bie në persëritje. Ky program është shumë i rëndësishëm, sepse ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit në përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimaterike, parandalimin dhe menaxhimin e riskut , ka të bëjë me turizmin ,

trashëgiminë kulturore, rininë dhe arsimin. Të gjitha këto që janë prioritete edhe për programin e qeverisë sonë. Natyrisht, ne nuk na mbetet gjë tjetër veçse ta mbështesim këtë projektligj.

Duke u konsultuar do të ngre një shqetësim që ka lidhje me një interferencë ose parashikim të përmirësimit të vendkalimeve kufitare, mes Shqipërisë dhe Kosovës, sepse infrastruktura ka probleme dhe kjo është një problematikë delikate e duhur, duke pasur parasysh edhe shkëmbimin e madh të mallrave dhe të njerëzve në pikun e turizmit, meqë jemi duke folur edhe për turizmin, këto pika, duke mos pasur infrastrukturën e nevojshme bëhen pengesë për realizimin e asaj që ka edhe ky program, përmirësimin e turizmit në Shqipëri.

I ftoj kolegët ta vlerësojnë dhe ta mbështesin projektligjin, por në të njëjtën kohë do të kisha dëshirë që ky sugjerim të shikohet dhe nëse ka hapësira do të kishte shumë vlerë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ndreu!

Në fakt, tani është momenti për pyetje nga ana e kolegëve. Paraprakisht, doja t'i vijë në dijeni përfaqësuesit e Ministrisë së Jashtme se komisioni ynë, për shkak edhe të objektit të punës që i ngarkon Rregullorja e Kuvendit, ka ndërmarrë një monitorim të të gjitha pikave të kalimit kufitar në vend. Arsyeja pse ne i kërkuam Konferencës së Kryetarëve që kjo marrëveshje së bashku me një marrëveshje tjetër të ngjashme po me Maqedoninë, t'i kalonte komisionit tonë, ishte për të parë nëse projekte të ndryshme që do të mund të realizohen me fondet e dhëna nga Bashkimi European do të mund të përmbanin edhe aspektin e përmirësimit të infrastrukturës në pikat e kalimit kufitar, sepse për sa kohë që pikat e kalimit kufitar vuajnë problemet e infrastrukturës dhe jo vetëm, do të thotë që bashkëpunimi ndërkufitar nuk mund të jetë në ato nivele që ne do të dëshironim.

Fjala është për zotin Vorpsi.

Më pas të gjithë kolegët mund të bëjnë pyetje.

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Pyetja ime është gjithmonë në raport me investimet. Kam relacionin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave, ku përcaktohet investimi total prej 4 milionë eurosh si program IPA, ku 1,2 milionë janë fonde të Bashkimit European dhe 180 mijë është kontributi i dy qeverive. Sa është investimi i qeverisë shqiptare? Pyetja e parë.

Pyetja e dytë. Lexoj këtu se kontributi i BE-së është 1 milion e 200 mijë, ndërkohë që më poshtë thuhet: “Sqarojmë më poshtë se kontributi që do të japë BE-ja për zbatimin e përbashkët

të programit Shqipëri-Kosovë, për periudhën 2014-2020 arrin vlerën 8 milionë e 400 mijë euro”. Pyetja ime ka lidhje me periudhën 2014-2020.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, fjalën e ka zonja Çekani.

Daniela Çekani – Faleminderit, për pyetjen!

Sikurse e përmendi edhe zoti Barbullushi, programi i bashkëpunimit ndërkufitar i referohet perspektivës financiare 2014-2020, prandaj edhe shifrat që u përmendën i takojnë kësaj periudhe në totalin e saj, ndërkohë që sot do të miratohen vetëm rialokimet e vitit 2016, për të cilat u reflektuan shifra të tjera.

Sa i takon përqindjes së kontributit kombëtar, ju sqaroj se ajo është në vlerën 15%, ndërkohë që granti i BE-së është në nivelin 85% dhe çdo vit subjekt nënshkrimi janë marrëveshjet për alokimet përkatëse të çdo viti. Pra, meqenëse Komisioni Europian ka rregullin N+3, që do të thotë alokimet financiare që miratohen kontraktohen pas 3 vjetësh dhe fillojnë zbatimin e tyre, kërkesa sipas rregullores IPA është që këto marrëveshje të miratohen çdo vit, nëpërmjet alokimeve vjetore.

(Diskutime pa mikrofon)

Për të gjithë periudhën financiare, por ne i parashikojmë të ndara në vitet respektive.

(Diskutime pa mikrofon)

Po. Pra ne gjithmonë, edhe granti i BE-së...

Sadi Vorpsi – 90 mijë euro për qeverinë shqiptare...

Daniela Çekani - Në shifra konkrete për momentin nuk mund t’jua them, por çdo vit edhe kontributi kombëtar u referohet 2 vendeve, edhe granti i BE-së u referohet 2 vendeve që kanë kontribuar së bashku që në programimin dhe hartimin e programit dhe implemtim.

Sadi Vorpsi – Parashikimi është që Kosova është përfituese më e madhe...

Daniela Çekani – Kjo bëhet në përlllogaritje në bazë...

Sadi Vorpsi – Në 12 bashki të paktën, por për ne janë dy qarqe, qarku i Kukësit dhe i Lezhës...

Daniela Çekani – Bëhet një përlllogaritje më teknike që lidhet edhe me numrin e popullsisë së vendeve, ka një lloj ndarjeje, e cila bëhet përgjatë procesit të programimit që është bërë 3 vjet më parë. Do të doja të shtoja diçka sa i takon kërkesës për ta pasur në konsideratë çështjen e pikave kufitare. Aktualisht, në program, sikundër mund ta keni vënë re në relacion, gjë

që e përmendi dhe zoti Barbullushi, në tre prioritetet e tij, nuk është parashikuar aktualisht pika e infrastrukturës së pikave doganore. Ndërkohë, është adresuar nëpërmjet një projekti strategjik financimi i rrugës që të çon në kufirin, në qoftë se nuk gaboj Shishtavec-Kruce. Nga ana e palës kosovare është bërë një investim i tillë dhe ne mund ta orientojmë këtë gjatë programimit të IPA 3, që është perspektiva tjetër financiare, për të cilën kanë filluar të mblidhen idetë e para fillestare se ku mund të shkojnë prioritetet, pasi gjatë periudhës së programimit të këtij programi gjatë kësaj perspektive nuk është vlerësuar si prioritet i rëndësishëm i të dyja vendeve, pasi të gjitha prioritetet që vijnë nga çdo qeveri dhe çdo strukturë operative kombëtare negociohen së bashku me Komisionin European dhe më pas me një listë prej 10 prioritetesh, përfundojmë një listë më të prioritetizuar të dy ose tre, që janë në përputhje me interesat e dy vendeve.

Këtë gjë do ta kemi në konsideratë, sepse fillimisht jemi në momentin e duhur për të hedhur hapat e parë drejt procesit të programimit të ardhshëm.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Çekani!

Pa dashur të ndërpres pyetjet e kolegëve, nëse mundemi ta vijojmë shpjegimin që ju dhatë. Nga pikëpamja praktike, si do të fillojë të zbatohet kjo marrëveshje, a mund të na shpjegoni diçka? Kur pritet të fillojë zbatimi i saj? Kam përshtypjen se ju thatë se do të fillojnë në vitin 2019?

Daniela Çekani – Kontraktimi i projekteve, të cilat do të shpallen fituese. Faktikisht, ratifikimi i këtyre marrëveshjeve është iniciuar nëpërmjet një interpretimi të Ministrisë së Financave, sepse më parë efektet financiare të marrëveshjes fillonin direkt pas miratimit me vendim të Këshillit të Ministrave, por, meqenëse përfshihej edhe elementi bashkëfinancim, u vendos të kalonte për t’u ratifikuar në parlament, gjë që nuk ka ndodhur më parë.

Pra, efektet financiare kanë filluar. Aktualisht, ne po bëhemi gati për hapjen e thirrjes së dytë, që do të ndodhë pas ratifikimit të alokimeve vjetore 2016. Pas hapjes së kësaj thirrjeje për projekt-propozime, të gjithë personat e interesuar, përfituesit në këtë rast, të cilët janë domosdoshmërisht vetëm institucione qendrore, ministri në nivel qendror, por janë edhe autoritetet lokale, qarqet, bashkitë, grupe të tjera interesi, organizata jofitimprurëse, bazuar në një guidë aplikimesh dhe në sesionet informuese që Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme në rolin e saj si koordinator kombëtar i fondeve IPA organizon për të gjithë të interesuarit dhe fasiliton edhe marrëdhëniet e tyre, si dhe përcjell të gjithë informacionin e nevojshëm, aplikojnë dhe procesi i përzgjedhjes, më duhet t’jua shpjegoj edhe këtë gjë.

Pra, në këtë rast programi me Kosovën bëhet nga delegacioni i Bashkimit European në Tiranë, nëpërmjet thirrjes për aplikime për ekspertë vlerësues të jashtëm, të cilët kontraktohen nga ky delegacion dhe më pas bëjnë procesin e përzgjedhjes së fituesve. Në momentin që përzgjidhen fituesit, institucionet qendrore parashikojnë nga buxhetet e tyre respektive kuotën e bashkëfinancimit në varësi të shumës që ata do të menaxhojnë. Ndërkohë, organizatat jofitimprurëse dhe palët e tjera të interesit e mbulojnë atë me burimet e tyre dhe më pas fillon edhe implementimi. Pra, është një periudhë 1 ose 2-vjeçare derisa të bëhen efektive rezultatet e dukshme.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, programi i bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri- Kosovë 2014-2020 ka disa objektiva dhe një ndër ta është edhe integrimi social- ekonomik i të rinjve.

Unë do doja të dija nga ana juaj: çfarë keni pasur parasysh në këtë objektiv dhe çfarë do të bëni?

Faleminderit!

Daniela Çekani - Gjatë hartimit të manualit të programit Shqipëri-Kosovë nuk është se kemi parashikuar aktivitete konkrete në këtë objektiv. Ajo i takon më shumë partneriteteve të krijuara. Pra, në momentin që ka partneritet midis institucioneve dhe organizatave jofitimprurëse Shqipëri-Kosovë, të gjitha së bashku përbëjnë në vetvete një konsorcium dhe ata draftojnë, në varësi të titullit që ka projekti, brenda këtij objektivi, një listë të mirëfilltë aktiviteteve, ku përcaktojnë edhe rolet që do të ketë secili partner. Sigurisht që çdo partneritet ka një lider projekti, i cili mund të jetë lider nga ana shqiptare, por edhe nga ana kosovare dhe partneriteti më pas varion. Secili prej tyre sikundër, ka një paketë financiare për të menaxhuar, ka edhe një set aktiviteteve për të menaxhuar. Integrimi mund të jetë nëpërmjet aktiviteteve konkrete në terren për të përfshirë të gjitha grupet vulnerabël, si dhe personat me aftësi të kufizuara. Pra, aktivitetet që definojnë organizatat që punojnë në këtë fushë mund të kenë natyrë të ndryshme. Ne i kemi definuar si një objektiv të gjerë për të pasur mundësi për të futur aty gjithçka, përveç komponentit infrastrukturor, që nuk mund të bëhet pjesë e objektivit. Pra, ka shumë elemente dhe partneritete garantojnë që secili të mbulojë një aspekt të caktuar. Kjo është në vlerësimin e aplikuesve.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Çekani!

Ndërkohë, dua t'u them kolegëve që së bashku me ne është edhe zëvendësministrja e Brendshme, zonja Rovenë Voda.

Faleminderit, zonja Voda!

Në mënyrë që t'ju përfshijmë edhe juve në diskutim, ideja e kësaj seance është që ky komision të kuptonte nëse një marrëveshje e tillë bashkëpunimi ndërkufitar do t'i shërbente edhe përmirësimit të infrastrukturës së pikave të kalimit kufitar. Ndërkohë, nga shpjegimet e zotit Barbullushi dhe zonjës Çekani, kuptuam që kjo marrëveshje është negociuar më herët në vitin 2016 dhe nuk ka qenë në diskutim posaçërisht kjo pikë, që ne mendojmë se është e rëndësishme së bashku me të gjitha pikat e tjera, që marrëveshja përmban në vetvete.

Kështu, do ta shfrytëzonim prezencën tuaj në këtë moment, meqenëse ka filluar edhe negociimi për fondet IPA 3, që të mund të shikohej si pjesë e rënies dakord të dy qeverive fqinje, sepse nuk është domosdoshmëri e palës kosovare, por është edhe me palët e tjera, që pikat kufitare, sidomos ato që janë me shkëmbim më të madh ndërkufitare si Kakavija, pika e kalimit kufitar të Qafë-Thanës, të Qafë- Botës, e cila shikohet si një pikë me goxha fluks, pika kufitare e Muriqanit në pjesën veriore, por edhe pika kufitare e Morinës. Sipas peshës së rëndësisë që kanë këto pika kufitare, por edhe volumit të shkëmbimeve që realizohen në to, qoftë të udhëtarëve, qoftë të mallrave, të mund të shikoheshin më mirë, në mënyrë që marrëveshje të tilla të garantonin, së pari, infrastrukturën e këtyre pikave të kalimit kufitar. Kuptohet që ato janë impakti i parë i çdo shtetasi të huaj ose jo që vjen në Shqipëri për tregti, për biznes apo për veprimtari të tjera shoqërore.

Kështu, nëse doni mund të shtoni edhe ju diçka nga pozita e institucionit të Ministrisë së Brendshme.

Rovenë Voda – Faleminderit, zonja kryetare!

Mirëdita, të nderuar deputetë!

Në fakt, unë jam dakord me çfarë thatë, që kjo marrëveshje është negociuar më herët, në vitin 2016. Nga relacioni kuptohet qartë, në fakt, që nuk e prek pjesën e ristrukturimit apo përmirësimit të shërbimit në pikat e kalimeve kufitare. Ndoshta ky është momenti, dhe unë ju falënderoj që ju si komision e sillni në vëmendje këtë gjë, në prani edhe të përfaqësuesve të Ministrisë së Jashtme, të cilët, sigurisht, mbulojnë edhe pjesën e integritetit, që është patjetër e domosdoshme, madje unë do të thosha jetike, në mënyrë që të mos e shikojmë vetëm si pjesë të sigurisë. Pra, kur me të drejtë themi pikat e kalimit kufitar, të mos i shikojmë të lidhura vetëm me sigurinë, sepse ato janë shumë të lidhura edhe me ekonominë, edhe me zhvillimin e një zone të

tërë në vendin ku ato ndodhen. Me të drejtë ne kemi pika kufitare, ku tashmë numri i qytetarëve që udhëtojnë në vit shkon me qindra e mijëra dhe patjetër duhet të jetë një tjetër fokus. Pra, herë tjetër, kur kemi mundësi, ne duhet të aplikojmë dhe Ministria e Jashtme të na mbështesë te pjesa e bashkëpunimit ndërkufitar, në mënyrë që mbështetja për përmirësimin e infrastrukturës në pikat e kalimit kufitar të jetë një nga kushtet që mund të negociohet në kuadër të fondeve të paraasistencës së anëtarësimit në BE.

Unë bashkohem tërësisht me propozimin që sapo bëtë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Voda!

Zonja Çekani, a kishit edhe ju diçka të fundit, para se të kalojmë në miratim?

Daniela Çekani - Dua të saktësoj diçka.

Sigurisht, ne i referohemi sot vetëm programit me Kosovën, sepse ky objektiv mund të jetë pjesë e prioriteteve të programeve të tjera, si me Maqedoninë apo programeve bilaterale, por sot po fokusohemi vetëm te Kosova. Gjithashtu, janë bërë ndërhyrje të tilla në disa pika, të cilat ju i përmendët, por ne, si Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, do ta kemi në konsideratë që sa herë do të jemi pjesë e këtyre komisioneve, të sjellim të dhëna edhe më të sakta sidomos lidhur me këtë objektiv dhe këtë komponent. Për programin me Kosovën, sigurisht që do ta orientojmë në vijim.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Në fakt, në këtë komision për dhënie mendimi do të shikohet edhe marrëveshja tjetër e ngjashme me Maqedoninë, kështu që besoj se do të kemi rast që t'i diskutojmë në mënyrë më të hollësishme.

Fjalën e ka zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Kjo marrëveshje është ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionin European. Këto fonde Komisioni European ua jep vendeve që janë në zhvillim dhe vendeve që duan të aderojnë në komunitetin european. Unë mendoj se këto fonde duhen shfrytëzuar sa më mirë nga ana jonë për përmirësimin dhe për qëllimin që kanë në mbrojtjen e mjedisit, përshtatjen e kushteve klimaterike, turizmin, trashëgiminë dhe rininë në arsim.

Në lidhje me këtë program, kush do të angazhohet për realizimin e këtyre programeve, për hapjen dhe zhvillimin e këtij konkurrimi dhe shpalljen e fituesit, sepse janë shumë lekë të hedhura në atë zonë kufitare?

Ne si komision ishim për vizitë në pikat kufitare të Qafë-Botit, Kakavijës dhe Qafë-Thanës. Po të shikosh paraqitjen e kufirit tonë në Qafë-Thanë dhe Qafë-Botë, nuk ka as pemë edhe as lule, pra nuk kanë ambient. Investimet të bëhen në këto pika ku bëhet edhe prezantimi i parë i Republikës së Shqipërisë apo i Kosovës. Pra, të fillojë sistemimi dhe investimi për mjediset, se turistët kur vijnë, e kuptojnë menjëherë se me kë kanë të bëjnë. Aty nuk ka asnjë investim, bari është i tharë dhe ambientet janë pis. Për mua kjo është shumë e rëndësishme.

Ministria e Jashtme do të merret me organizimin e programeve dhe tenderimin e tyre?

Ermonela Felaj – Po, zonja Çekani.

Daniela Çekani – Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme është në rolin e koordinatorit kombëtar të fondeve IPA. Siç e përmenda edhe më parë, autoriteti kontraktor është delegacioni i Bashkimit Europian në Tiranë, i cili bën përzgjedhjen e projekteve fituese, nëpërmjet vlerësuesve të jashtëm që ky delegacion kontraktton.

Përgjegjësinë për implementimin e projekteve dhe ndërhyrjeve jo vetëm në pikat kufitare, por në çdo projekt e kanë institucionet përgjegjëse të angazhuara me partnerët respektivë mes Kosovës dhe Shqipërisë.

Roli ynë është ai i koordinatorit kombëtar. Arkitektura institucionale përbëhet edhe nga struktura të tjera, siç është autoriteti menaxhues. Në këtë rast kemi sekretariatën e përbashkët teknik, kemi strukturat operative të autoriteteve kombëtare të të dyja vendeve, kemi një komitet të përbashkët monitorimi me përfaqësues të të dyja shteteve, të cilët kanë votën e tyre për miratimin e projekteve të përzgjedhura fituese në përputhje me objektivat.

Duhet ta theksoj që roli i ministrisë është koordinator dhe nuk ka zë të paktën në programin për të cilin ne jemi vend udhëheqës në raport me Kosovën.

Vullnet Sinaj – Ideimin e temave të projekteve kush do ta bëjë?

Daniela Çekani – Këto i përcaktojnë partneritetet që ngrihen, pra një partner shqiptar në bashkëpunim me një partner kosovar, ose janë katër, ose pesë të tillë. Për programin dhe për thirrjet rrespektive, në momentin që lançohen për publikun dhe për të gjithë të interesuarit, ne përgatisim një manual aplikimi dhe një guidë që i ndihmon ata për të kuptuar se cilat janë kriteret që duhet të plotësojnë. Këtë e bëjmë nëpërmjet sesioneve informuese në ambientet e Ministrisë për Europën

dhe Punët e Jashtme, që ata të jenë shumë të qartë për rrugën që duhet të ndjekin. Partneritetet janë fryt i bashkëpunimit ndoshta të mëparshëm të njohjeve respektive, pra ministria nuk ndërhyr në këtë rast. Kjo është në varësi edhe të fushës së tyre të veprimit, ata kanë kontaktet e tyre në vendet e rajonit.

Vullnet Sinaj – Qëllimi i asaj që dua të them është të dimë të informojmë mirë edhe organizatat jofitimprurëse, por edhe drejtuesit e zonave në qarqe dhe në bashki, për të ditur si të hedhim hapin për fillimin e këtyre projekteve, së bashku me qeverinë apo institucionet e Kosovës. Informimi paraprak është shumë i nevojshëm.

Daniela Çekani – Është e vërtetë. Ne e bëjmë këtë bazuar në një plan komunikimi dhe informimi me dakordësinë e përbashkët mes shteteve dhe delegacionit të Bashkimit Europian. Ky është detyrimi ynë, në varësi edhe të rregullores së IPA-s dhe janë gjithmonë të programuara shumë më parë sesa të fillojnë aplikimet dhe të lançohen thirrjet për projekt-propozimet.

Vullnet Sinaj – Zonja kryetare, ashtu siç miratojmë projektligjet, të kemi edhe të drejtën për të kontrolluar se çfarë është bërë, si janë zbatuar këto projekte, pra të shkojmë në kufirin Shqipëri - Kosovë për të parë investimet dhe projektet se çfarë rezultati kanë dhënë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Dakord, kjo është shumë e drejtë. Unë besoj se Ministria e Europës dhe Punëve të Jashtme ka të gjithë gatishmërinë për të na sqaruar në vijim se çfarë ndodh me fonde të tilla, ku shkojnë dhe si përkthehen në pjesën e bashkëpunimit ndërkufitar.

Zoti Duzha ka një pyetje.

Luan Duzha – Faleminderit, zonja kryetare!

Kisha një pyetje, nga programi “IPA I” zonat kufitare si Kukësi apo Lezha a kanë përfituar ndonjë projekt?

Daniela Çekani – Aktualisht programi “IPA I” është mbyllur, por sigurisht që përfitues kanë qenë qarqet e konsideruara si zona të ligjshme të programeve, sepse çdo program, në varësi të shteteve pjesëmarrëse, ka zona të përcaktuara që konsiderohen të ligjshme. Në rastin e programit me Kosovën janë Kukësi, Shkodra dhe rrethi i Tropojës. Sigurisht që përfituesit janë nga këto zona dhe çdo partneritet ka një minimum partnerësh në varësi të programit që u takon zonave që janë të ligjshme. Pra jo domosdoshmërisht nga Kosova aplikojnë përfitues nga Tirana, por janë edhe nga zona të tjera, ku implementohen aktivitetet.

Ermonela Felaj – Fjalën e ka zoti Ndreu.

Pjerin Ndreu – Po qyteti i Lezhës çfarë projektesh ka përfituar nga programet “IPA 1” dhe “IPA 2”?

Daniela Çekani – Ju kërkoj ndjesë se nuk kam një databazë të përgatitur për emra konkret projektesh, por ne mund t’jua vëmë në dispozicion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne i kemi, por unë nuk i kam sot me vete. Ne kemi përcjellë informacion për parlamentin më shumë sesa një rast me lista të plota të projekteve të përfituara, sepse i takojnë një perspektive financiare që janë mbrapa në kohë dhe nuk mund të memorizohen.

Ermonela Felaj – Aplikuesit janë subjekte private apo janë bashkitë?

Daniela Çekani – Jo, janë bashkitë, qarqet, institucionet qendrore, organizatat jofitimprurëse, universitetet, dhomat e tregtisë dhe të Unionit, të gjithë këta janë të ligjshëm për të aplikuar.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Çekani!

Duke marrë shkas nga pyetja e zotit Ndreu, unë kërkoj që të na vini në dispozicion këtë listë. Ky komision nuk ka qenë i përfshirë në diskutime dhe marrëveshje të tilla, sikurse dhe Ministria e Brendshme nuk ka qenë e përfshirë, ashtu siç rezultoi në këtë mbledhje dhe besoj se kjo do t’i shërbejë përmirësimit të hartimit të marrëveshjeve të tilla, që përfitues të jenë zona që realisht kanë nevojë dhe për të cilat shteti ka edhe interes në këtë pikë.

Nëse nuk ka pyetje të tjera nga kolegët, kalojmë në votimin e marrëveshjes.

Kush është dakord me marrëveshjen në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nën për nen të marrëveshjes.

Neni 1. Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord edhe me nenin 2, që përcakton hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me marrëveshjen “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Europian, “Për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar “IPA

II”, Shqipëri – Kosovë, 2014-2020, alokimet për vitin 2016”)? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet marrëveshja në këtë komision.

Faleminderit për prezencën të dyja ministrive.

Mbledhja mbyllet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar

Pjerin Ndreu

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit

Antonela Veshi